



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIC OF KOSOVO
REPUBLIKA KOSOVA
KOMUNA E PEJËS / MUNICIPALITY OF PEJA / OPŠTINA PEĆ



KUVENDI I KOMUNËS SË PEJËS
I.Numër: 016/01-8782, dt.26 Shkurt 2026.

Në bazë të nenit 11 e nenit 12.2 pika d) dhe nenit 25.2 të Ligjit Nr.03/L – 040 Për Vetëqeverisjen Lokale të Republikës së Kosovës (“Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës, Nr.28.datë: 04.qershor 2008”), nenit 5. paragrafi 2. të Ligjit për Ndërmarrjet Publike të Republikës së Kosovës Nr.03/L – 087 datë: 13 qershor 2008, nenit 20, paragrafi 1 pika 1.4. të Statutit Nr.01/2020 të Komunës së Pejës, I.Numër:01-016/01-413431 dt. 30. Shtator 2020, Kuvendi Komunal Pejë, në takimin e mbajtur me datë: 26 Shkurt 2026, merr:

VENDIM
Nr.05/2026

mbi themelimin e Komisionit Komunal të Aksionarëve të
N.P.L. “STACIONI I AUTOBUSËVE” SH.A. PEJË

- Emërohet Komisioni Komunal i Aksionarëve për ushtrimin e të drejtës aksionare të Komunës së Pejës, në N.P.L. “Stacioni i Autobusëve” sh.a. me seli në Pejë, në përbërje:
 - Diellza Berisha, anëtare e emëruar nga Kryetari i Komunës.
 - Arsim Selmonmusaj , anëtarë i Kuvendit Komunal nga subjekti politikë LDK, dhe
 - Albi Shala , anëtarë i kuvendit komunal nga subjekti politikë PDK.
- Komisioni nga pika 1 e këtij Vendimi do të ushtrojë të drejtën e Komunës së Pejës, si aksionare në N.P.L. “Stacioni i Autobusëve” sh.a. me seli në Pejë, konform nenit 5. paragrafi 2 të Ligjit Nr.03/L-087 Për Ndërmarrjet Publike, si dhe duhet të veproi në përputhje me Ligjin Nr. 06/L -016 për Shoqëritë Tregtare.
- Për Zbatimin e këtij Vendimi do të kujdeset kryetari i Komunës së Pejës.
- Me këtë Vendim shfuqizohet Vendimi Numër: 660 -03/5360 dt. 31 Janar 2022, mbi themelimin e KKA të N.P.L. “Stacioni i Autobusëve” sh.a. me seli në Pejë.
- Ky vendim shpallet tridhjetë (30) ditë pas regjistrimit në Zyrën e protokollit të Ministrisë për Administrimin e Pushtetit Lokal dhe hynë në fuqi shtatë (7) ditë pas publikimit në gjuhë zyrtare në web-faqen e Komunës së Pejës.

Vendimi i dërgohet:
MAPL,
Kryetarit të Komunës,
DBF dhe anëtareve të zgjedhur,
Arkivë.



KRYESUESI KUVENDIT,
Rexhep Kurtbogaj